

# ZONA E SHENGENIT

**Acquis për Shengenin** zbatohet në tërësi për territoret evropiane të shteteve anëtare të BE-së në vijim: **Belgjikën, Republikën Çeke, Gjermaninë, Estoninë, Greqinë, Spanjën (përfshirë Ishujt Baleares dhe Ishujt Kanarie), Francën, Kroacinë, Italinë, Letoninë, Lituaninë, Luksemburgun, Hungarinë, Maltën, Holandën, Austrinë, Poloninë, Portugalinë** (duke përfshirë **Madeiran dhe Azorët**), **Slloveninë, Sllovakinë, Finlandën dhe Suedinë**

**Danimarka** është shtet anëtar i BE-së që ka pozicion të veçantë për sa i përket zbatimit të acquis të Shengenit. Asaj i duhet ta zbatojë tërësisht acquis të Shengenit, jo si ligj të BE-së, por si obligim sipas së drejtës ndërkombëtare. Si rrjedhojë, Danimarka nuk voton kur masat e Shengenit miratohen nga BE-ja.

**Islanda**, Lihtenshtajni, Norvegjia (përveç Svalbardit) dhe Zvicra, të cilat nuk janë shtete anëtare të BE-së, janë të lidhura me zbatimin e acquis të Shengenit nëpërmjet Marrëveshjeve të Asociimit. Ato e kanë të drejtën për të qenë të pranishme dhe për të dhënë sugjerime gjatë përgatitjes së akteve të acquis të Shengenit që miratohen pastaj nga institucionet e BE-së. Ato duhet t'i zbatojnë të gjitha aktet e Shengenit pas miratimit të tyre nga.

**Bullgaria, Rumania dhe Qipro** janë shtete anëtare të BE-së të detyruara nga i tërësisht acquis i Shengenit. Megjithatë, ato ende nuk i zbatojnë pjesët e acquis që kanë të bëjnë me mungesën e kontrolleve në kufijtë e brendshëm, duke përfshirë visat. Bullgaria dhe Rumania janë gjithashtu të lidhura me Sistemin Informativ të Shengenit. Qiproja do të jetë plotësisht e lidhur me Sistemin Informativ të Shengen nga 23 korriku i vitit 2023. Kontrollat në kufijtë e brendshëm me këto shtete anëtare mund të hiqen vetëm si rezultat i ndonjë vendimi të miratuar nga Këshilli.

**Irlanda** është shtet anëtar i BE-së që nuk merr pjesë në bashkëpunimin në kuadër të Shengenit. Megjithatë, ajo mund të kërkojë dhe të autorizohet që të marrë pjesë në disa pjesë të acquis të Shengenit për sa i përket bashkëpunimit policor dhe gjyqësor në çështjet penale. Sot, Irlanda i zbaton përkohësisht fushat e acquis të Shengenit në të cilat ka kërkuar të marrë pjesë, duke përfshirë Sistemin Informativ të Shengenit në lidhje me policinë

Lëvizjet për dhe nga **Ceuta** dhe **Melilla**, **Ishujt Faroe** dhe **Grenlanda** u nënshtrohen rregullave specifike.

Kufijtë me **Andorrën, Monakon, San Marinon dhe Qytetin e Vatikanit** u nënshtrohen rregullimeve specifike të kontrollit sipas së drejtës kombëtare ose ndërkombëtare.